



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:195467

Datë: 04.09.2023

Numri i dokumentit: 04725489

C.nr.1003/19

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjyqtari Bekim Salihu, me bashkëpunëtorin profesional Fatlum Halimi, në çështjen juridike të inicuar me padinë e paditësve: I.Z nga Ferizaj, Rr.”...” dhe SH.Z, A.Z dhe A.Z nga fshati, Komuna Ferizaj, të cilët me autorizim i përfaqëson Xhavit Topalli avokat nga Ferizaj, kundër të paditurit N,K ish nga fshati, Komuna Ferizaj, tani me adresë të panjohur, të cilin e përfaqëson Përfaqësuesi i Përkohshëm, Xhavit Mahmuti avokat nga Ferizaj, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, në seancën e mbajtur më datën 11.08.2023, mori ndërsa me 28.08.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve: I.Z nga Ferizaj, si dhe SH.Z, A.Z dhe A.Z, të gjithë nga fshati, Komuna Ferizaj, si e bazuar.

II. VËRTETOHET se paditësit e lartpërmendur, sipas bazës së mbajtjes dhe posedimit me mirëbesim për më shumë se 20 vite, janë pronar të parcelave të cilat gjenden në Zonën Kadastrale, Komuna Ferizaj, në vendin e quajtur “...” me sipërfaqe dhe kufijë të specifikuar sipas ekspertizës gjeodezike të dt.18.07.2023 të punuar nga eksperti gjeodet M.L., dhe atë si në vijim:

-Paditësi **I.Z**;

1. është pronar me **1/1** të pjesës ideale të pronësisë në sipërfaqen prej m² që është pjesë e parcelës **nr.....** ZK, e cila sipërfaqe përkufizohet: *në anën veriore në gjatësi prej 46.60m kufizohet me pjesën e parcelës ZK*; *në anën lindore në gjatësi prej ...5m kufizohet me parcelën.... ZK*; *në anën jugore në gjatësi prejm kufizohet me parcelënZK*; në

anën perendimore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelës ... ZK, ku eksperti gjeodet kësaj sipërfaqe i ka rekomanduar numrin e ri ZK.

2. është pronar me **1/1** të pjesës ideale të pronësisë në sipërfaqen prej ... m² që është pjesë e parcelës **nr.....**, e cila sipërfaqe përkufizohet: *në anën veriore në gjatësi prej ...m kufizohet me parcelën.... ZK*; *në anën lindore në gjatësi prejm kufizohet me parcelën.... ZK*; *në anën jugore në gjatësi prejm kufizohet me parcelënZK*; *në anën perendimore në gjatësi prejm kufizohet me parcelën.... dhe në gjatësi prej ...8m kufizohet me pjesën e parcelës ZK*, ku eksperti gjeodet kësaj sipërfaqe i ka rekomanduar numrin e ri **ZK.**

3. është pronar me **1/1** të pjesës ideale të pronësisë të parcelës **nr.....**, **ZK.**, në sipërfaqe prej ...m², tokë e klasit 5, me kulturë livadhë.

4. është pronar me **1/1** të pjesës ideale të pronësisë të parcelës **nr.....**, **ZK.**, në sipërfaqe prej m², tokë e klasit 6, me kulturë arë .

-Padiësi A.Z;

- është pronar me **1/1** të pjesës ideale të pronësisë në sipërfaqen prej m² që është pjesë e parcelës **nr.....**, **ZK**, më shfrytëzim oborr , e cila sipërfaqe përkufizohet *në anën veriore në gjatësi prejm kufizohet me rrugë publike; në anën lindore në gjatësi prej ...2m kufizohet me parcelën.... ZK*; *në anën jugore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelës....ZK*; *në anën perendimore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelës ZK*, për të cilën sipërfaqe eksperti gjeodet ka rekomanduar numrin e ri **ZK**

-Padiësi SH.Z;

- është pronar me **1/1** të pjesës ideale të pronësisë në sipërfaqen prej m² që është pjesë e parcelës **nr.....**, **ZK**, e cila sipërfaqe përkufizohet: *në anën veriore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelës ZK*; *në anën lindore në gjatësi prej ...1m kufizohet me parcelën.... ZK*; *në anën jugore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelës.... ZK*; *në anën perendimore në gjatësi prej ...m kufizohet me pjesën e parcelës ZK*, ku eksperti gjeodet kësaj sipërfaqe i ka rekomanduar numrin e ri **ZK.**

-Padiësi A.Z;

- është pronar me **1/1** të pjesës ideale të pronësisë në sipërfaqen prej ...m² që është pjesë e parcelës **nr....** **ZK**, e cila sipërfaqe përkufizohet: *në anën veriore në gjatësi prejm*

*kufizohet me pjesën e parcelës ZK; në anën lindore në gjatësi prej ...m kufizohet me parcelën..... ZK; në anën jugore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelës.... ZK; në anën perendimore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelës ZK, ku eksperti gjeodet kësaj sipërfaqe i ka rekomanduar numrin e ri **ZK.***

III. Paditësit I.Z, A.Z, SH.Z dhe A.Z:

- janë pronar me $\frac{1}{4}$, të pjesës ideale të pronësisë në sipërfaqen prej m², që është pjesë e parcelës **nr..... ZK**, e cila shfrytëzohet si rrugë dhe e cila *sipërfaqe përkufizohet: në anën veriore në gjatësi prejm kufizohet me rrugë publike; në anën lindore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelës ZK; në anën jugore në gjatësi prejm kufizohet me parcelënZK; në anën perendimore në gjatësi prejm kufizohet me parcelëndhe në gjatësi prej 70.84m kufizohet me parcelën ZK.....* e për të cilën sipërfaqe eksperti gjeodet ka rekomanduar numrin e ri **ZK**

- janë pronar me $\frac{1}{4}$, të pjesës ideale të pronësisë në sipërfaqen prej m², që është pjesë e parcelës **nr.....**, e cila shfrytëzohet si rrugë dhe e cila *sipërfaqe përkufizohet: në anën veriore në gjatësi prejm kufizohet me parcelënZK; në anën lindore në gjatësi prej ...m kufizohet me pjesën e parcelës.... ZK; në anën jugore në gjatësi prej ...m kufizohet me pjesën e parcelës..... ZK; në anën perendimore në gjatësi prej ...m kufizohet me parcelën..... ZK*, e për të cilën sipërfaqe eksperti gjeodet ka rekomanduar numrin e ri **ZK**

IV. Shpenzimet e procedurës i bartin paditësit.

A r s y e t i m i

Paditësit më datën 06.09.2019 kanë paraqitur padi pranë kësaj gjykate, me të cilën kanë kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë për parcelat me nr.:.....,,....., Z.K., Komuna Ferizaj, mbi bazën e mbajtjes dhe shfrytëzimit me mirëbesim.

Me që të paditurit nuk i dihej vendbanimi aktual, paditësit gjatë seancës përgaditore, i kanë propozuar gjykatës që të paditurit t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm. Në këtë rast gjykata pas përmbushjes së kushteve ligjore e ka aprovuar propozimin e tillë dhe me vendimin C.nr.1003/19, të datës 07.03.2023, të paditurit i'a ka caktua për përfaqësues të përkohshëm

avokatin Xhavit Mahmuti nga Ferizaj. Poashtu, paditësit kanë kërkuar edhe nxjerrjen e provës dhe vërtetimin e gjendjes faktike përmes ekspertit të gjeodezisë si dhe ka propozuar të dëgjohen dëshmitarë, të cilat kërkesa janë aprovuar nga gjykata gjatë shqyrtimit përgaditor si të bazuara.

Gjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësve ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe thekson se paraardhësi i paditësve, i ndjeri R.Z (babai i paditësve I.Z dhe A.Z, respektivisht gjyshi i paditësve SH.Z dhe A.Z) paluajtshmërinë kontestuese e ka blerë në vitin 1968 përmes marrëveshjes gojore nga tani i padituri N.K. I autorizuari i paditësve më tej deklaroi se paraardhësi i paditësve e kishte paguar në tërësi çmimin e shitblerjes dhe kishte hyrë në posedim të paluajtshmërisë ku kishte ndërtuar shtëpinë, ndërsa tani pasardhësit e tij e kanë në posedim dhe shfrytëzim të papenguar nga askush, ku kanë ndërtuar shtëpi të reja dhe jetojnë me familjet e tyre të pa penguar apo shqetësuar nga askush. Andaj, i autorizuari i paditësve ka propozuar kërkesëpadiat e paditësve të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe paditësit të shpallen pronarë të paluajtshmërisë kontestuese konform ekspertizës gjeodezike dhe atë si në vijim: paditësi I.Z është bashkëpronar me $\frac{1}{4}$ të pjesës ideale të pronësisë në parcelën nr.....në sipërfaqe prej m², të cilës i është propozuar numër i ri e cila shfrytëzohet si rrugë; paditësi A.Z është pronar me $\frac{1}{1}$ të pjesës ideale të pronësisë të parcelës nr.....në sipërfaqe prej m², të cilës eksperti gjeodet i ka propozuar numër të ri; paditësi SH.Z është pronar me $\frac{1}{1}$ të pjesës ideale të pronësisë të parcelës nr.....në sipërfaqe prej m², të cilës eksperti gjeodet i ka propozuar numrin e ri; A.Z është pronar me $\frac{1}{1}$ të pjesës ideale të pronësisë të parcelës nr.....në sipërfaqe prej m², të cilës eksperti gjeodet i ka propozuar numrin e ri; I.Z është pronar me $\frac{1}{1}$ të pjesës ideale të pronësisë të parcelës nr.....në sipërfaqe prej m², të cilës eksperti gjeodet i ka propozuar numër të ri; paditësit I.Z, SH.Z, A.Z dhe A.Z janë pronarë secili me nga $\frac{1}{4}$ të pjesës ideale të pronësisë të parcelës nr.....në sipërfaqe prej 26 m² që shfrytëzohet si rrugë, të cilës eksperti gjeodet i ka propozuar numër të ri; paditësi I.Z është pronar me $\frac{1}{1}$ të pjesës ideale të pronësisë të parcelës nr.....në sipërfaqe prej m², të cilës eksperti gjeodet i ka propozuar numër të ri, si dhe është pronar me $\frac{1}{1}$ të pjesës ideale të pronësisë në parcelën nr.....në sipërfaqe prej m², si dhe pronar me $\frac{1}{1}$ të pjesës ideale të pronësisë të parcelës nr..... në sipërfaqe prej 7813 m², të gjitha gjenden në vendin e quajtur “...” Z.K., Komuna Ferizaj, në bazë të mbajtjes dhe shfrytëzimit me mirëbesim për më tepër se 40 vite.

Përfaqësuesi përkohshëm i të paditurit, gjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga gjendja faktike e vërtetuar në terren, shihet se paditësit e kanë në shfrytëzim këtë

pronë të papenguar nga askush në periudhë të gjatë kohore, por edhe nga dëshmitarët e dëgjuar, u kuptua se paditësit e shfrytëzojnë këtë pronë diku prej fillimit të viteve 1970, të papenguar nga askush, si dhe u vëretetua fakti se pronari juridik i këtyre pronave, pas shitjes së pronave në atë lagje, së bashku me fqinjët e tij ishin shpërngulur nga Kosova, për në Kroaci dhe nga ajo kohë asnjëherë nuk kanë paraqitur asnjë shqetësim të tyre me të cilën do të mund t'u kundërshtohet e drejta e pronësisë paditësve, andaj i propozon gjykatës që në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar gjatë kësaj procedure, të marr vendim meritor. Sa i përket deklaratës noteriale të trashëgimtarëve, nuk e kundërshton, ngase tregon vullnetin e pasardhësve-familjarëve të tjerë të paditësve, të cilët kanë shprehur vullnetin lidhur me pronën kontestuese. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës sipas vendimit të gjykatës të dt.10.02.2023.

Me qëllim të vërtetimit plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për aq sa palët ndërgjygjëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar provat dhe faktet e çështjes, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, Gjykata ka bërë administrimin e tyre me si vijon: ekspertiza gjeodezike e ekspertit M.L. e dt.18.07.2023; certifikata e pronësisë nr..... e dt.25.05.2023 lidhur me parcelat objekt kontesti; plotësim ekspertiza gjeodezike nga eksperti M.L e dt.10.08.2023; deklarata noteriale LRP.nr..... e dt.....

Gjykata, pasi bëri shqyrtimin dhe analizimin e provave të çështjes, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka bërë vlerësimin e tyre veç e veç dhe të ndërlidhura mes veti, si tërësi, dhe mbi bazën e bindjes së lirë të krijuar mbi bazën e fakteve dhe provave të çështjes, ka vlerësuar se duhej vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Përmes certifikatës së pronësisë gjykata vërtetoi faktin se parcelat objekt kontesti në këtë procedurë, figurojnë në emër të të paditurit N,K.

Përmes deklaratës noteriale LRP.nr.2...5/23, të dt.10.08.2023, gjykata vërtetoi faktin se pasardhësit e të ndjerit R.Z, gjegjësisht trashëgimtarët e N.Z: I.Z, I.Z, S.Z – A, B.Z – O dhe A.Z, kanë hequr dorë nga e drejta e pronësisë në parcelat lëndë kontesti, në favor të paditësve.

Përmes ekspertizës gjeodezike si dhe plotësimit të asaj ekspertize, gjykata vërtetoi faktin se paditësit janë në shfrytëzim të parcelave kontestuese sipas sipërfaqeve dhe kufijve të përshkruar si në ekspertizë.

Dëshmitari F.Z. nga fshati, ka deklaruar se jeton në fshatin, që nga viti 1967 dhe në kohën kur kanë ardhë familjarët e paditësve për të jetuar aty, ai ishte dikun i moshës 10 vjeç.

Dëshmitari shton se babai i paditësve këtë pronë e ka blerë nga N,K që ka qenë i nacionalitetit malazez, i cili është shpërngulur nga ky vend rreth viteve 1980 apo 1981 pas demonstratave të asaj kohe, e din faktin se i kanë shitur pronat e tyre dhe gjithë banorët e nacionalitetit malazez të asaj lagje janë shpërngulur në atë kohë, ndërsa thekson faktin se prej kohës që e kanë në shfrytëzim këtë pronë paditësit, asnjëherë nuk kanë pasur problem nga askush.

Dëshmitari I. Sh, ka deklaruar se jeton në fshatin dhe shton se ka qenë shumë i vogël ndoshta i moshës 6-7 vjeçare kur është shpërngulur nga fshati i tij në vitet e 50-ta, për në Ferizaj, por i kujtohet fakti se babai i paditësve ka ardhur në atë lagje për të jetuar dikund në fund të viteve të 60-ta dhe fillim të viteve të 70-ta, por sakt nuk i kujtohet sepse ka kaluar periudhë e gjatë kohore. Dëshmitari deklaron se babai i paditësve i ka blerë nga i cili ka qenë malazez dhe shton faktin se deri më tani nuk ka dëgjuar asnjëherë që dikush është ankuar lidhur me posedimin e këtyre pronave, por çmimin e sakt sa është blerë nuk e di, sepse në atë kohë ka qenë me dinar dhe thekson gjatë blerjes dhe pagesës së çmimit ka qenë prezent. Në pyetjet e të autorizuarit të paditësve, dëshmitari përgjigjet se shtëpitë e ndërtuara në pronat kontestuese janë ndërtuar dikund para luftës në Kosovë dhe pastaj pas ndarjes së vllaznive, shtëpitë janë ndërtuar pas lufte, e që nuk janë penguar në posedimin e tyre nga askush asnjëherë.

Eksperti i gjeodezisë M.L nga shënimet kadastrale ka gjetur se parcelat,, 0....dhe 0.... ende figurojnë në emër të të padituri N,K. Nga dalja në vend ngjarje, eksperti gjeodet ka konstatuar se ka dallime në mes gjendjes juridike dhe asaj faktike, pasi që parcelat bazë shfrytësohen nga paditësit në pjesë dhe sipërfaqe të ndryshme. Pas konstatimit të gjendjes faktike, matjeve të bëra në teren dhe llogaritjes së sipërfaqeve për secilin paditës-posedues faktik, eksperti gjeodet ka hartuar raportin me shkrim, të cilin e ka plotësuar me raportin e dt.10.08.2023, ku ka rekomanduar që parcelat bazë, të ndahen dhe të marrin numra të rinjë dhe sipërfaqe të caktuar, dhe t'u takojnë paditësve si më poshtë:

Kufizimi i pronës me pronat tjera:

Pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se pjesa e parcelëspër të cilën ja kam propozu numrin e ri kadastral ZKkufizohet: në anën veriore në gjatësi prej ...m kufizohet me rrugë publike; në anën lindore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelësZK; në anën jugore në gjatësi prejm kufizohet me parcelënZK; në anën perendimore në gjatësi prej ...m kufizohet me parcelën ...dhe në gjatësi prejm kufizohet me parcelën ZK..... Në pjesën e parcelëspër të cilën ja kam propozu numrin e ri kadastral

ZK ... për të cilën është objekt kontesti për vërtetimpronësie nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt, por është rrugë e shtruar me asfalt.

Pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se pjesa e parcelëspër të cilën ja kam propozu numrin e ri kadastral ZKkufizohet: Në anën veriore në gjatësi prej ...m kufizohet me rrugë publike; në anën lindore në gjatësi prejm kufizohet me parcelën.... ZK; në anën jugore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelës....ZK; në anën perendimore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelësZK Në pjesën e parcelëspër të cilën ja kam propozu numrin e ri kadastral ZK për të cilën është objekt kontesti për vërtetim pronësie ka të ndërtuar një shtëpi dhe një shup dhe pjesa tjetër është oborr.

Pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se pjesa e parcelëspër të cilën ja kam propozu numrin e ri kadastral ZKkufizohet: Në anën veriore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelësZK; në anën lindore në gjatësi prejm kufizohet me parcelën.... ZK; në anën jugore në gjatësi prej ...m kufizohet me pjesën e parcelës....ZK; në anën perendimore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelësZK Në pjesën e parcelëspër të cilën ja kam propozu numrin e ri kadastral ZK për të cilën është objekt kontesti për vërtetimpronësie ka të ndërtuar një shtëpi dhe pjesa tjetër është oborr.

Pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se pjesa e parcelëspër të cilën ja kam propozu numrin e ri kadastral ZK kufizohet: Në anën veriore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelësZK; në anën lindore në gjatësi prej ...m kufizohet me parcelën.... ZK; në anën jugore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelës....ZK; në anën perendimore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelësZK Në pjesën e parcelëspër të cilën ja kam propozu numrin e ri kadastral ZK për të cilën është objekt kontesti për vërtetimpronësie ka të ndërtuar një shtëpi dhe pjesa tjetër është oborr.

Pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se pjesa e parcelëspër të cilën ja kam propozu numrin e ri kadastral ZKkufizohet: Në anën veriore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelësZK; në anën lindore në gjatësi prejm kufizohet me parcelën.... ZK; në anën jugore në gjatësi prejm kufizohet me parcelënZK; në anën perendimore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelësZK Në pjesën e parcelëspër të cilën ja kam propozu numrin e ri kadastral ZK për të cilën është objekt kontesti për vërtetimpronësie nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt, por është livadh.

Pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se pjesa e parcelëspër të cilën ja kam propozu numrin e ri kadastral ZK kufizohet: Në anën veriore në gjatësi prej ...m kufizohet me parcelënZK; në anën lindore në gjatësi prej ...m kufizohet me pjesën e parcelës....ZK; në anën jugore në gjatësi prejm kufizohet me pjesën e parcelës....ZK; në anën perendimore në gjatësi prej ...m kufizohet me parcelën.... ZK Në pjesën e parcelëspër të cilën ja kam propozu numrin e ri kadastral ZK për të cilën është objekt kontesti për vërtetimpronësie nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt, por është rrugë e shtruar me asfalt.

Pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se pjesa e parcelëspër të cilën ja kam propozu numrin e ri kadastral ZK kufizohet: Në anën veriore në gjatësi prej ...m kufizohet me parcelën....ZK; në anën lindore në gjatësi prej ...m kufizohet me parcelën.... ZK; në anën jugore në gjatësi prejm kufizohet me parcelënZK; në anën perendimore në gjatësi prej ...m kufizohet me parcelën.... dhe në gjatësi prej ...m kufizohet me pjesën e parcelësZK Në pjesën e parcelëspër të cilën ja kam propozu numrin e ri kadastral ZK për të cilën është objekt kontesti për vërtetimpronësie nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt, por është livadh.

Pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se parcelapër tëZK kufizohet: Në anën veriore në gjatësi prejm kufizohet me parcelën....ZK; në anën lindore në gjatësi prejm kufizohet me parcelën.... ZK; në anën jugore në gjatësi prejm kufizohet me parcelënZK; në anën perendimore në gjatësi prejm kufizohet me parcelën... ZK Në parcelënZK e cila është objekt kontesti për vërtetimpronësie nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt, por është livadh.

Pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se parcela ZK kufizohet: Në anën veriore në gjatësi prejm kufizohet me parcelën....ZK; në anën lindore në gjatësi prej ...m kufizohet me parcelën..... ZK; në anën jugore në gjatësi prej ...m kufizohet me parcelën ... dhe në gjatësi prejm kufizohet me parcelën ZK, komuna Kaçanik; në anën perendimore në gjatësi prej ...m kufizohet me parcelën... dhe në gjatësi prej ...m kufizohet me parcelën ZK..... Në parcelën ZK e cila është objekt kontesti për vërtetimpronësie ka të ndërtuar një shtëpi dhe pjesa tjetër është livadh.

Konstatimi dhe mendimi i ekspertit:

Sipas matjeve të bëra në terren më datë 17.07.2023 dhe përpunimit tëmatjeve në zyrë konstatoj se sipërfaqja e gjendjes faktike është prej m², konkretisht:

Nga parcelashfrytëzohen m² dhe unë si ekspert ja propozojnumrin e ri kadastral ZK me sipërfaqe m² e cila është rrugë të cilën e shfrytëzojn I.Z me pjesë të pronës ¼, SH.Z me pjesë të pronës ¼, A.Z me pjesë të pronës ¼ dhe A.Z me pjesë të pronës ¼.

Nga parcelashfrytëzohen m² dhe unë si ekspert ja propozojnumrin e ri kadastral ZK me sipërfaqe m² të cilën e shfrytëzon A.Z me pjesë të pronës 1/1.

Nga parcelashfrytëzohen m² dhe unë si ekspert ja propozojnumrin e ri kadastral ZK me sipërfaqe m² të cilën e shfrytëzon SH.Z me pjesë të pronës 1/1.

Nga parcelashfrytëzohen m² dhe unë si ekspert ja propozojnumrin e ri kadastral ZK me sipërfaqe m² të cilën e shfrytëzon A.Z me pjesë të pronës 1/1.

Nga parcelashfrytëzohen m² dhe unë si ekspert ja propozojnumrin e ri kadastral ZK me sipërfaqe m² të cilën e shfrytëzon I.Z me pjesë të pronës 1/1.

Nga parcelashfrytëzohen ... m² dhe unë si ekspert ja propozojnumrin e ri kadastral ZK me sipërfaqe m² e cila është rrugë të cilën e shfrytëzojn I.Z me pjesë të pronës ¼, SH.Z me pjesë të pronës ¼, A.Z me pjesë të pronës ¼ dhe A.Z me pjesë të pronës ¼.

Nga parcelashfrytëzohen m² dhe unë si ekspert i'a propozojnumrin e ri kadastral ZK me sipërfaqe m² të cilën e shfrytëzon I.Z me pjesë të pronës 1/1.

Parcelënshfrytëzohen m² të cilën e shfrytëzon I.Z me pjesë të pronës 1/1.

Parcelën shfrytëzohen ... m² të cilën e shfrytëzon I. Z me pjesë të pronës 1/1.

Nga deklarimi i palëve ndërgjyqjese, dëshmitarëve dhe provave të administruara në këtë procedurë, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: Se paraardhësi e paditësve R.Z pronën objekt shqyrtimi e ka blerë në vitin 1969 nga i padituri N.K, në bazë të marrëveshjes gojore, e poashtu është vërtetuar fakti se i njëjti i'a kishte paguar çmimin e shitblerjes në tërësi dhe kishte hyrë menjëherë në posedim dhe shfrytëzim të pronës objekt kontesti. Nga dëshmia e dëshmitarëve dhe nga konstatimi i gjendjes faktike përmes ekspertit të gjeodezisë, gjykata ka konstatuar se paditësit pronën kontestuese e kanë në posedim dhe shfrytëzim të vazhdueshëm dhe të papenguar nga askush që nga viti 1968 e në vazhdim, ku kanë ndërtuar shtëpi banimi, objekte përcjellëse dhe kanë mbjellur kopshte frutore. Dëshmime dhe provave të administruar në këtë procedurë, gjykata u'a fali besimin e plotë dhe të njejtat i konsideroi si të vërteta, të paanshme dhe profesionale.

Gjykata në këtë rast, konstatoi shfrytëzimin me mirëbesim të pronës kontestuese për më shumë se 50 vite dhe mbi këtë bazë paditësit e fitojnë të drejtën e pronësisë mbi pronën kontestuese. Pra, gjykata vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore që paditësve të ju njihet e

drejta e pronësisë në pronat kontestuese, sepse nga ana e tyre janë plotësuar të gjitha kushtet kumulative për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi bazën e mbajtjes dhe shfrytëzimit me mirëbesim të paluajtshmërisë për një periudhë më të gjatë se 20 vite (respektivisht 50 vite) dhe se gjykata i vërtetoi këto fakte nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, konstatimet nga vendi i ngjarjes, dëshmia e dëshmitarëve dhe provat tjera materiale të administruara në këtë procedurë kontestimore.

Andaj, nga këto arsye, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar në tërësi dhe e njejta duhet të aprovohet.

Nga të lartë cekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 28 të Ligji për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore dhe nenit 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës bazohet në dispozitën e nenit 450 të LPK-së, ku shuma e deponuar në llogari të gjykates do ti bartet në llogari të përfaqësuesit të përkohshëm në shumë prej 1,020.00€ e cila shumë është deponuar me aktvendimin e datës 10.02.2023, në emër të përfaqësimit dhe përgjigjes në padi përfaqësuesin e përkohshëm.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.1003/19 më datë 28.08.2023

**Gjyqtari,
Bekim Salihu**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.